# KLGJ NUK PRANON KËRKESËN E ILD-SË PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT A.D.

BY ILD 18 PRILL, 2024 PËR MEDIAT




Në seancën e sotme Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka rrëzuar kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) për dhënien e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra" për magjistratin A.D., me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për shkelje të rënda profesionale.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor, bazuar në ankesën e depozituar nga një qytetare pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në vitin 2019 dhe përcjellë për kompetencë ILD-së, mbi lirimin me kusht nga gjyqtari A.D., të një të dënuari përsëritës në shkelje të ligjit.

shkeljes disiplinore.

Ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, si dhe ka cënuar besimin e publikut te drejtësia. Në përfundim të hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludoi se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit A.D. përbëjnë "*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*", duke diskretituar pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, dhe i propozoi KLGJ-së masën disiplinore *"Shkarkim nga detyra"*, kërkesë që u rrëzua nga ky Këshill.

## NJOFTIM

Për të lehtësuar edhe më shumë procesin e ankimimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sjell një formë të re, më të thjeshtuar të ankesës, që qytetarët apo institucionet mund të paraqesin për shkelje të dyshuara nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.

Ky shënim shpjegues i procedurës shoqërohet me shembuj konkretë të vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për secilin nga kriteret, të përcaktuara në ligj mbi pranueshmërinë dhe shqyrtimin e ankesave.

*Për më shumë informacion, ju lutem klikoni këtu.*

## Faqe

Kreu

Kontakt

Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë

Vende Vakante

Për Mediat

Buletini Mujor

Harta

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Strategji

Marrëveshje

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve

Anketë mbi veprimtarinë e ILD-së

Njoftim Publik për Shpallje Vendimi